

Nga: Njesia per Menaxhimin e Projektit per rajonin Nderkufitar "Prespa"

Per: Grupin e Aktoreve per Rajonin Nderkufitar "Prespa"

Subjekt: Ftese per takimin e 10-te te Grupit te Aktoreve per Rajonin Nderkufitar "Prespa"

Te nderuar,

Eshte kenaqesi per ne te ftojme perfaqesues nga institucioni/organizata tuaj te marrin pjese ne takimin e ardhshem te 10-te te Grupit te Aktoreve per Rajonin Nderkufitar "Prespa", i cili do te organizohet ne daten 23 Qershor 2015, ne [Hotel Millennium Palace](#) ne Oher, Republika e Maqedonise.

Grupi Permanent i Punes per Zhvillimin Rural Rajonal (SWG) ne Evropen Juglindore eshte duke vazhduar me aktivitetet lidhur me implementimin e (ABDA) ne vendet e Ballkanit Perendimor dhe tani ka filluar me zbatimin e projektit te financuar nga BE: "Forcimi i bashkepunimit rajonal dhe zhvillimi i balancuar territorial i vendeve te Ballkanit Perendimor ne procesin e integritimit ne BE"

Projekti ka si qellim nxitjen e bashkepunimit rajonal ndermjet institucionve dhe grupeve te interesit ne sektorin e bujqesise dhe ushqimit, si edhe lehtesimin e procesit te zhvillimit te balancuar territorial ne vendet e Ballkanit Perendimor ne progresin drejt integritimit ne BE. Qellimi i projektit eshte te fuqizojë rrjetezimin (network) dhe bashkepunimin midis institucioneve publike dhe grupeve te interesit, si edhe organeve te tjera rajonale me qellim pershpjtimin e procesit te antaresimit ne BE te vendeve kandidate dhe potencialisht kandidate te Ballkanit Perendimor ne fushen e bujqesise dhe zhvillimit rural.

Projekti do te perfshije pjesemarrjen e politikebersve ne procesin e dialogut, se bashku me aktoret kryesore duke perfshire perfaqesues nga qeverisja lokale, shoqeria civile, perfaqesues nga biznesi, OJQ-ve dhe grupe te tjera nga shoqeria civile si akademike, eksperte dhe do te stimuloje kulturen e dialogut dhe diskutimin e ceshtjeve te ndryshme e te rendesishme per bujqesine dhe politikat e zhvillimit rural si edhe ceshtjeve te zhvillimit ekonomik rural ne zonat nderkufitare.

Zbatimi i projektit nga SWG do te theksoje rendesine e bashkepunimit funksional, te pergjegjshem, transparent dhe bashkepunim gjithepershires mes vendeve te Ballkanit Perendimor, duke garantuar perfaqesim rajonal.

Gjate implementimit te projektit SWG-ja do te promovojë bashkepunimin rajonal si nje platforme, ne koordinimin me strukturat rajonale ne kater zonat target nderkufitare ("Drina-Tara", "Drina-Sava", "Prespa" dhe "Sharra"), permes lehtesimit te procesit te rritjes se kapaciteteve, si dhe shperndarjen e informacioneve mbi ceshtjet kryesore te zhvillimit ekonomik dhe financimeve ne dispozicion.



Aktivitetet e projektit do te perqendrohen gjithashtu ne lehtesimin e procesit te arritjeve te qellimeve strategjike te zhvillimit, te percaktuara ne kuader te kornizes strategjike dhe Programeve per zhvillimin ekonomik te rajoneve.

Kjo do te realizohet permes shperndarjes se informacioneve rreth mundesive per fondeve ne dispozicion, si dhe mbeshtetje per grupet e aktoreve rajonale ne krijimin e rrjeteve, aranzhim e takimeve interaktive, ndihmen dhe lehtesimin e procesit te pergatitjes se projekt propozimeve per thirrjet e ndryshme per projekte sidomos ato brenda instrumenteve IPA.

Projekti do te vazhdoje te punoje ne ndertimin dhe konsolidimin e kapaciteteve dhe strukturave brenda SWG-se dhe rajoneve te perzgjedhura si dhe vazhdimin e aktiviteteve per te siguruar fonde per zbatimin e Kornizes Strategjike Zhvillimore dhe Programeve per Zhvillimi Ekonomik te pregatitura per rajonet e perzgjedhura ne kuader te projekteve te meparshme.

Pervec kesaj SWG-ja do te inicioje fillimin e pregatitjes se Analizes Baze, Planifikimin Strategjik dhe Programet per Zhvillim Ekonomik ne te pakten dy rajone nderkufitare, duke lehtesuar procesin e rrjetezimeve ne rajon, permes dialogut dhe evenimenteve rrjetezuese.

Temat kryesore ne takim do te jene:

- Informimi rreth fazes se 3-te te projektit ABDA "Forcimin e bashkepunimit rajonal dhe zhvillimi i balancuar territorial i vendeve te Ballkanit Perendimor ne procesin e integritimit ne BE - Suporti i (SWG) ne Evropen Juglindore" - implementimi dhe aktivitetet e ardhshme ne lidhje me projektin:
- Diskutim mbi mbeshtetjen e mundshme per aktivitetet "Njerezit tek Njerezit" ne rajonin "Prespa"
- Diskutim rreth projekt propozimeve per Zhvillimin e Integruar Ekonomik dhe rolin e Njesise se Menaxhimit te Projektit per rajonin nderkufitar "Prespa"
- Diskutim rreth emerimit te antareve te SHG (afirmimi i antareve aktuale dhe perfshirjen e antareve te rinj)

Takimi i 10-te i Grupit te Aktoreve per Rajonin Nderkufitar "Prespa" do te zhvillohet me 23 Qershor 2015, ne [Hotel Millennium Palace](#) ne Oher, Republika e Maqedonise.

Eshte kenaqesi e madhe per ne t'ju mirepresim ne kete takim.

Ju lutem gjeni bashkangjitur programin e propozuar dhe informacione logjistike.

Shihemi se shpejti ne Oher

Singerisht,

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal per rajonin nderkufitar "Prespa"
Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale per rajonin nderkufitar "Prespa"

